



NEK Umwelttechnik AG investon 240 milionë euro në Kosovë në prodhimin e energjisë së erës

Christoph Kapp, shëf ekzekutiv i kompanisë NEK Umwelttechnik AG nga Zvicra në një intervistë ekskluzive për Radio Kosovën, njofton për investimet që kjo kompani planifikon t'i bëjë në ngritjen e tri parqeve për prodhimin e energjisë së pastër me turbinat e erës në Zatriq, Budakovë dhe Qyqavicë. Ai thotë se projekti do të realizohet brenda tre vitesh dhe do të kushtojë nga 210 deri në 240 milionë euro, që është investimi më i madh i huaj deri më tani në Kosovë.

POSTUAR 12:40 / 23.08.2013

Intervistoi: Fadil Gashi

Radio Kosova: Po punoni për ngritjen e tre parqeve për prodhimin e energjisë së erës në Kosovës. Çfarë mund të thoni më shumë?

Christoph Kapp: "NEK Umwelttechnik AG, Zürich" nga Zvicra, ka filluar në Kosovës që nga viti 2008 zhvillimin e projekteve për përfitim të energjisë nga era. Duke qenë se në Kosovë nuk ka pasur matje lidhur me të dhënat për zonat ku fryn era dhe fuqia e intensitetit të erës është më e madhe, kompania është dashur që në vende të caktuara të realizojë matjet e fuqisë së erës, të cilat kanë zgjatur më shumë se një vit. Pastaj kompania ka përpunuar të dhënat në një Atlas të erës për rajonin e Kosovës, ku është mbuluar pjesa më e madhe e territorit të Republikës së Kosovës, në të cilat janë piketuar vendet ku frynë era më e madhe. Pastaj kompania ka vendosur të përcaktojë pikën e parë ku do të ngrite parku i parë i turbinave që prodhojnë energji me erë e ky do të jetë bjeshka e Zatriqit, komuna e Rahovecit.

Radio Kosova: Mund të na thoni disa hollësi si do të duket ky park i projektit për energjinë e erës në Zatriq. Sa turbine të erës do të vendosen atje?

Christoph Kapp: Projekti për parkun e energjisë së erës në Zatriq do të përbëhet nga 15 turbina, përkatësisht mullinj të erës që prodhojnë energji elektrike, me ç' rast secila turbinë do të prodhojë nga 3.0 MW energji elektrike. Lartësia e turbinave do të jetë 100 m. Në total parku i turbinave të erës në Zatriq do të prodhojë 45 MW energji elektrike. Tashmë kemi parashtruar kërkesën tonë tek ERO (Energy Regulatory Office) në Prishtinë për fillimin e punëve në Zatriq. Ndërkohë, projekti ka marrë licencën provizore nga ERO (shihni këtu Webfaqen e ERO nën këtë link www.ero-ks.org). Gjithashtu tashmë kemi bërë kërkesën për lidhjen e parkut të turbinave të erës me rrjetin energjetik të Kosovës dhe aktualisht jemi në përmblyllje të bisedimeve me KOST-in. Besojmë se në muajt e ardhshëm do të marrim të gjitha lejet e nevojshme në mënyrë që në pjesën e dytë të vitit të ardhshëm të fillojmë punimet në Zatriq. Pasi kemi bërë studimet në parkun e Zatriqit, ku do të fillojmë me realizimin e projektit, kemi lançuar edhe një projekt tjetër – atë të Budakovës në komunën e Suharekës

Radio Kosova: Çfarë mund të thoni për parkun e energjisë së erës që planifikoni të ngrisin në Budakovë?

Christoph Kapp: Siç e thash, parku për prodhimin e energjisë së erës në Budakovë është në komunën e Suharekës. Atje gjithashtu për vite të tëra kemi realizuar matjet e intensitetit të erës dhe kemi zhvilluar një projekt me të cilin kemi planifikuar vendosjen e 16 turbinave, ku si në rastin e Zatriqit, secila prej turbinave do të prodhojë 3.0 MW- energji elektrike që në total i bie 48 MW, ndërsa edhe për këtë projekt kemi marrë licencën provizore nga autoriteti rregullues ERO. Zhvillimi i këtij parku të energjisë së erës është më i lehtë pas ai i Zatriqit. Po presim që lejen për fillimin e punimeve ta marrim në fillim të vitit të ardhshëm në mënyrë që ndërtimi parakut në Budakovë të fillojë në vitin 2015

Radio Kosova: Keni folur për tri projekte të tilla. Cili është projekti i tretë?

Christoph Kapp: Pas realizimit të punëve dhe planeve për dy projekte e përmendura, kemi vendosur edhe realizimin e projektit të tretë – atë në Qyqavicë, në Komunën e Vushtrisë. Ky projekt i tretë është në zhvillim e sipër dhe matjet e kryera tregojnë se është një vend shumë i përshtatshëm për ngritjen e një parku të tretë të energjisë së erës. Në Qyqavicë planifikojmë vendosjen e 17 turbinave nga 3.0 MW, kështu që në total ky projekt do të prodhojë 51 MW energji elektrike. Parku e energjisë së erës në Qyqavicë kemi planifikuar ta ndërtojmë në vitet 2015/2016.

Radio Kosova: Kush qëndron prapa projektit: Është NEK (Ghana) Ltd ,oder Eolica Dobrogea AG apo NEK Umwelttechnik AG, Zürich?

Christoph Kapp: Injineri dhe i tërë zhvillimi i projektit është bërë nga kompania zvicerane NEK Umwelttechnik AG, Zürich. Në Prishtinë tashmë kemi themeluar edhe Degën tonë: "NEK Umwelttechnik AG" dega në Kosovë. Aty po bëjmë punët lokale, ndërsa të drejtat e projektit janë në pronësi të SPV's (special purpose vehicles), që dot ë thotë se:

"Upwind International I GmbH", Pfäffikon, Zvicër, është pronar i parkut të erës Zatriq.

"Upwind International II GmbH", Pfäffikon, Zvicër, është pronar i parkut të erës në Budakovë dhe

"Upwind International III GmbH", Pfäffikon, Zvicër është pronar i parkut të erës në Qyqavicë.

Të gjitha planet për Parqet e energjisë së erës të realizuara nga "NEK Umwelttechnik AG" janë autorizuar nga kompania Upwind.

Radio Kosova: Sa kohë kërkon ndërtimi i një parku për prodhimin e energjisë elektrike me turbinat e erës?

Christoph Kapp: Punimet për ndërtimin e një parku marrin së paku 12 muaj, pro kjo varet shumë edhe nga kushte atmosferike. Në dimër p.sh. në vendet me lartësi mbidetare mbi 1000 metra, kryerja e punimeve është më e vështirë për

- [TE FUNDIT](#)
- [TE LEXUARA](#)
- [TE SHPERNDARA NE FB](#)

- 13:36 [Gjuriq: Jam i gatshëm t'u përgjigjem të gj...](#)
- 12:33 [Musa Limani: Në Kosovë ekziston vetëm një ...](#)
- 12:40 [NEK Umwelttechnik AG investon 240 milionë ...](#)
- 12:04 [Baraliu: Lista zgjedhore serbe prish balan...](#)
- 13:29 [Hoxhiq: Nuk besoj se deri më 30 shtator mu...](#)
- 07:25 [Zegjiri: Institucionet nuk angazhohen për D...](#)
- 13:58 [Tahiri: Kodi telefonik ndërkombëtar 383 ap...](#)
- 11:02 ['Rriqra e madhe' - agresive në Malishevë](#)

STREAM LIVE / TV - RADIO



MOTI

Prishtinë 14-20 °C	Gjilan 13-19 °C	Prizren 16-22 °C
Pejë 15-21 °C	Mitrovicë 14-20 °C	Ferizaj 13-19 °C
Gjakovë 15-21 °C		

FACEBOOK - TWITTER



shkak të ftohtit që mbretëron
Radio Kosova: Zoti Kapp sa kushtojë këto projekte?

Christoph Kapp: Të tri projektet?

Radio Kosova: Po!

Christoph Kapp: Të tri projekte kushtojnë përafërsisht nga 210 deri në 240 milion euro.

Radio Kosova: Kjo i bie që është investimi me i madh i huaj deri më tani në Kosova

Christoph Kapp: Korrekt.

Radio Kosova: Çfarë do të thotë kjo për Kosovën?

Christoph Kapp: Kosova ka problem me furnizimin e energjisë elektrike dhe problemin tjetër është se 98 e energjisë përfitohet nga linjit në termocentralet Kosova A dhe Kosova B, gjë që ndot ambientin jashtë standardeve evropiane. Kosova ka nevojë të përfitojë energji të pastër nga burime të ripërtitshme që nuk e ndotin ambientin. Këtu ne do të japin kontributin tonë me këto tre projekt me të cilat do të prodhohen 150 MW energji elektrike e pastër që nuk do ta ndot ambientin e Kosovës.

 Share  Tweet

0

KOMENTO



Gjuriq: Jam i gatshëm t'u përgjigjem të gjitha sfidave

13:36 / 04.09.2013

Drejtori i katër stacioneve policore në veriun e Mitrovicës Nenan Gjuriq thotë se gjendja e tanishme në veri është e qetë dhe e qëndrueshme. ' Përveç ndonjë incidenti të izoluar të shkeljes së rendit dhe sigurisë publike në një masë më të vogël dhe...



Musa Limani: Në Kosovë ekziston vetëm një Mitrovicë

12:33 / 24.08.2013

Njëherë e përgjithmonë duhet të largohet dhe të mos përmenden emërimet Mitrovicë e veriut, Mitrovicë e jugut. Ajo është një dhe është e Kosovës. Kështu thotë eksperti ekonomik, Musa Limani. Në një intervistë për Radio Kosovën, profesori i Fakultetit ...



Baralau: Lista zgjedhore serbe prish balancet kushtetuese

12:04 / 22.08.2013

Eksperti i të drejtës kushtetuese, Mazlum Baralau, në një intervistë për Radio Kosovën ka thënë se ideja që serbët të marrin pjesë në zgjedhjet e 3 nëntorit me një listë të vetme zgjedhore, mund t'i prishin balancet kushtetuese të parapara në përfila...



Hoxhiq: Nuk besoj se deri më 30 shtator mund të shuhen strukturat paralele

13:29 / 16.08.2013

Koordinatorja e Zyrës Administrative në veri të Mitrovicës, Adriana Hoxhiq, në një intervistë për Radio Kosovën, ka thënë se klima në veri ka filluar të ndryshojë për të mirë, por ajo është shprehur skeptike se deri më 30 shtator do të mund të shuhen...



Zeqiri: Institucionet nuk angazhohen për Diasporën

07:25 / 08.08.2013

Shqiptarët në Zvicër dhe në diasporë në përgjithësi gjithnjë e më shumë po integrohen, mirëpo komuniteti shqiptar ende mbetet larg shkallës së arsimimit, që është një prej elementëve kryesor të integritimit. Kështu shprehet në një intervistë për Radio ...



Tahiri: Kodi telefonik ndërkombëtar 383 apo 384 do të jetë i Kosovës

13:58 / 07.08.2013

Bisedimet me Beogradin për çështjet e telekomunikacionit kanë përfunduar, kurse nesër pala serbe duhet të deklarohet nëse pranon propozimin e palës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për kodin telefonik ndërkombëtar të Kosovës. Kështu tha Zëvendës-kry...



'Rriqra e madhe' - agresive në Malishevë

11:02 / 05.08.2013

'Rriqra e Madhe', apo siç njihet ndryshe në gjuhën shkencore "Hyalomma", konsiderohet se është shkaktari kryesor i përhapjes së virusit që shkakton ethe hemorragjike – Krime Kongo. Një hulumtim njëvjeçar i bërë nga dr.sc. Kurtesh Sherifi, profes...



Zhbogar: Marrëveshja e Brukselit po sjell rezultate konkrete

15:34 / 31.07.2013

Shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë, Samuel Zhbogar, tha se marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, tani veç ka sjell rezultate konkrete si: integrimi i gjyqësisë dhe policisë në sistem të institucioneve kosovare, si ...

TITUJ TË TJERË



MARKETING

MARKETING

MARKETING

MARKETING

EKONOMI



Mirëpritjet vendimi i qeverisë për bllokadë ndaj Maqedonisë

Mirëpritjet vendimi i Qeverisë së Kosovës për bllokimin e mallrave nga Maqedonia. Njohës të...

KULTURË / ENTERTAINMENT



Duke interpretuar Verdin, vdes në skenë

Sopranoja Florencia Fabris ka ndërruar jetë pikërisht në skenën ku po performonte. Teatri ...

SPORT



Juventusit synon ta transferojë Adnan Januzajn

Talenti kosovar me nënshitetesi belge, Adnan Januzaj, është vënë në shënjestër të kampionit...



Sindikata kërkon ndërprerjen e procesit të privatizimit të PTK-së

13:13 / 09.09.2013



Prizreni bëhet me muze të hapur arkeologjik

14:38 / 09.09.2013



U hodh shorti për Ligën e femrave në futboll

14:35 / 09.09.2013



Mujota në një Forum për transport e telekomunikacion

10:34 / 08.09.2013

TITUJ TË TJERË



"Column" i Ujkan Hysaj kthehet me çmim të parë nga Pogradeci

12:05 / 09.09.2013

TITUJ TË TJERË



Ronaldo: Dyshja Kristiano-Bejl, do t'i sjellë shumë trofe Realit

13:03 / 09.09.2013

TITUJ TË TJERË



MARKETING

MARKETING

MARKETING

MARKETING



Video dhe audio shërbimet e rtklive.com mbështeten nga: 
Koha e shënuar është CET (Central European Time).
Copyright © RTK. All Rights Reserved. Powered by RTK Web Unit

Marketing
Ndihmë teknike
Mundësi Punësimi

Për RTK-në
Kontakttoni